



Republika e Kosovës-Kosova Çoruhliyeti Republika Kosova-Republic of Kosovo	
Mamusha Beledijesi-Komuna e Mamushës Gosina Mamusha-Municipality of Mamusa	
Eriş - Hyrëse - Ulazna - Incoming	
02	No.Nr. 028-20
15.06.2020	

Republika e Kosovës - Republika Kosova - Republic of Kosovo




Komuna Prizren



Komuna
Suharekë/SuvaReka



Komuna
Dragash/Dragaš



Komuna
Mamusha/
Mamuša/Mamuša

Memorandum Mirëkuptimi ndërmjet

**Komunës së Prizrenit
Komunës së Suharekës
Komunës së Dragashit,
Komunës së Mamushës,**

dhe

“Qendrës për strehimin e grave dhe fëmijëve”

Në përputhje me nenin 17.1.k të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (Ligji me nr. 03/L-040) dhe statutin e komunave përkatëse,

komuna e Dragashit, e Mamushës, e Prizrenit dhe e Suharekës (në tekstin e mëtejshëm: Komunitat) në njërin anë dhe

organizata joqeveritare që udhëheq me “Qendrën për Strehimin e Grave dhe Fëmijëve” (në tekstin e mëtejshëm: strehimorja) në anën tjetër, (të gjithë së bashku “palët”)

pajtohen të nënshkruajnë këtë

Memorandum Mirëbesimi

për mbulimin e pjesshëm të shpenzimeve të strehimores për një periudhë fillestare prej tre (3) viteve: 2020, 2021, 2022.

Neni 1 – Përshkrimi i Memorandumit

1.1 Ky memorandum siguron mbështetje të pjesshme financiare, e caktuar në bazë të këtij dokumenti për nevojat e strehimores për mbrojtjen e viktimave të dhunës në familje dhe dhunës mbi bazën gjinore dhe formave të tjera të dhunës, për periudhën trevjeçare 2020 - 2022.

- 1.2 Strehimorja gjendet në komunën e Prizrenit dhe u shërben viktimave të dhunës në familje, dhunës me bazë gjinore si dhe viktimave të formave tjera të dhunës nga të katër (4) komunat, të cilat janë palë nënshkruese të këtij memorandumi.
- 1.3 Në rast se ndonjëra nga palët nënshkruese nuk dorëzon një njoftim tjetër deri në datën e përfundimit të këtij memorandumi, ky memorandum ripërtërihet automatikisht për të njëjtën kohëzgjatje dhe me të njëjtat kritere, duke filluar nga data 1 janar 2023.

Neni 2 – Qëllimi i Memorandumit

- 2.1 Komunat do të kontribuojnë bashkërisht për nevojat financiare të strehimores siç është shprehur në përmbajtjen dhe frymën e këtij dokumenti.
- 2.2 Shkalla e kontributit vjetor që duhet të paguajë secila komunë për strehimoren llogaritet në përpjesëtim të drejtë me popullsinë që banon në Komunën përkatëse. Gjatë periudhës tre-vjeçare 2020-2022, Komunat mund të rrisin vullnetarisht kontributet e tyre financiare, mirëpo jo edhe ta ulin shumën për të cilën janë pajtuar.

Neni 3 – Detyrimet financiare

- 3.1 Shuma vjetore e kontributit të secilës komunë drejt financimit të përgjithshëm vjetor të strehimores për periudhën trevjeçare 2020-2022, në përputhje me numrin e popullsisë në secilën komunë, është si në vijim:

Komuna e Prizrenit:	€ 6,450
Komuna e Suharekës:	€ 2,200
Komuna e Dragashit:	€ 1,230
Komuna e Mamushës:	€ 1,000

- 3.2 Secila komunë siguron pjesën e caktuar të kontributit të vet financiar (shih 3.1) për secilin vit fiskal përkatës, përmes një kësti të vetëm që paguhet në xhirlologarinë e Strehimores, përbrenda tremujorit të parë të secilit vit fiskal. Kjo formë e pagesës do të jetë e vlefshme për tërë kohëzgjatjen e këtij memorandumi, përgjatë viteve 2020, 2021, 2022 si dhe më pas, në rast se ripërtërihet.
- 3.3 Format e pagesës mund të rishqyrtohen dhe të vendosen nga Komunat tre (3) muaj para përfundimit të këtij memorandumi, përmes një marrëveshjeje të veçantë e cila do të bëhet pjesë përbërëse e këtij memorandumi.

Neni 4 – Dispozitat përfundimtare

- 4.1 Para datës 31 janar të secilit vit fiskal, Strehimorja i paraqet secilës komunë raportin përfundimtar financiar, i cili konsiderohet si parakusht për shpërndarjen e kontributit financiar për vitin e ardhshëm. Format e lartpërmendura të raportimit do të vazhdojnë deri në përfundimin e memorandumit.
- 4.2 Në rast se strehimorja nuk raporton për shpenzimet e veta siç kërkohet në nenin 4.1 të këtij memorandumi, secila Komunë mund të ndalojë pagesën përkatëse deri në momentin kur informacioni i kërkuar të jetë siguruar plotësisht.

4.3 Ky memorandum hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit nga palët dhe pas vlerësimit të ligjshmërisë nga Ministria e administrimit të pushtetit lokal si dhe publikimit në Gazetën Zyrtare të Kosovës.

4.4 Kryetari i secilës komunë dhe drejtori apo drejtoresha e strehimore ka për detyrë të sigurojë zbatimin e plotë të pjesëve përkatëse të dispozitave të dakorduara në kuadër të këtij memorandum.

Neni 5 – Mosmarrëveshjet


5.1 Mosmarrëveshjet ndërmjet palëve do të zgjidhen sipas vullnetit të mirë të palëve.

Prizren, 15 qershor 2020


Palët nënshkruese:

Për Komunat

Mytaher Haskuka, Kryetar
Komuna e Prizrenit




Bali Muharremaj, Kryetar
Komuna e Suharekës



Shaban Shabani, Kryetar
Komuna e Dragashit



Abdullahi Krasniç, Kryetar
Komuna e Mamushës



Për Strehimoren

Jubilea Kabashi, Drejtoreshë
Qendra për Strehimin e Grave dhe Femijëve

